



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE
PER KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2026

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
(62 Mbartur nga viti 2025)	18.12.2025	Kërkesë për kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkojmë të na vendoset në dispozicion një kopje e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lidhur me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme (SPAK), për konfiskimin e pasurive të shtetasit E.M dhe	05.01.2025	Datë 05.01.2025 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 62, datë 18.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se vendimi nr. 17, datë 07.11.2025, në lidhje me kërkesën për konfiskim pasurie kundër subjektit	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		personave të lidhur me të, që janë shoqëritë “Z...” sh.p.k., “L...” sh.p.k.” dhe 49% të kuotave të shoqërisë “M...” sh.p.k.; 8 apartamente në **** me sipërfaqe totale 592.38 m2; tre ngastra tokë-arë në ****, me sipërfaqe totale 10 mijë e 342 m2; truall dhe masiv pyjor në ****, secila pasuri me sipërfaqe 6026 m2; dy garazhe dhe një bodrum në ****; si dhe 9 automjete të markave të ndryshme. Të dhënat mund të dërgohen me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës suaj.		E.M dhe personave të afërm, akoma nuk është zbardhur nga ana e gjykatës. Datë 03.02.2026 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 62, datë 18.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe në zbatim të ligjit nr. 124, dt. 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për efekt të mbrojtjes së të dhënave personale, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë të anonimizuar vendimin nr. 17, datë 07.11.2025, me subjekt shtetasin E.M.		
(64 Mbartur nga viti 2025)	29.12.2025	Kërkesë për kopje vendimi: Në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e	12.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 64, datë 29.12.2025 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		informimit”, i ndryshuar, neni 3, kërkojmë të na vendoset në dispozicion një kopje e vendimit nr.422 datë 23.10.2023, për masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” të pasurive të të pandehurit P.Gj. Po ashtu, kërkojmë të na vendoset në dispozicion çdo vendim tjetër të disponuar nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për sekuestrimin e pasurive të të pandehurit P.Gj (nëse ka). Sjellim në vëmendje se çështja është në gjykim dhe nuk ka cënim të sekretit hetimor, pasi palët në gjykim janë njohur me provat, që janë bërë publike dhe në seancat gjyqësore. Të dhënat mund të dërgohen me CD me postë ose në variant të printuar ose me transferim elektronik (e-mail) sipas dëshirës suaj.		përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Vendimi nr. 422, datë 23.10.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vendosjen e sekuestros preventive, që ju citoni në kërkesën tuaj, është një vendim i dhënë nga gjykata në dhomë këshillimi, gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 9, të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve P.Gj, etj. Deri më tani, nga kjo gjykatë nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë vendim për heqjen e sekuestros mbi pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 422, datë 23.10.2023, të sipërcituar. Aktualisht, këto pasuri vijnë të jenë të sekuestruara dhe janë objekt gjykimi në dosjen penale të themelit me nr. 27/96 regjistri themeltar, datë regjistrimi 07.05.2025, me të pandehur P.Gj, etj. Në pikën 3, të nenit 103 të K.Pr.Penale parashikohet	
--	--	--	--	---	--

				shprehimisht se: “<i>Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura.</i> <i>Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”.</i> Për sa më sipër, në kushtet që pasuritë e sekuestruara sipas vendimit nr. 422, datë 23.10.2023, të kësaj gjykate, vijojnë të jenë të sekuestruara dhe janë objekt gjykimi në dosjen penale të themelit, të sipërcituar, si dhe faktit që vendimi nr. 422, datë 23.10.2023, është dhënë nga gjykata në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, gjykata, bazuar në pikën 3, të nenit 103 të K.Pr.Penale refuzon kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion këtë vendim.		
(66 Mbartur nga viti 2025)	30.12.2025	Kërkesë për informacion në kuadër të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,	08.01.2026	Në përgjigje të email-it tuaj, të dërguar me datë 30.12.2025, nëpërmjet të cilit keni përcjellë shkresën nr. 4224 prot., datë 23.12.2025, të *****, me lëndë “Kërkesë për informacion në kuadër të ***** për ligjin nr. 10 192, datë	Në proces	Nuk ka

		ligji (Anti-mafia) i ndryshuar. A janë zbatuar plotësisht dispozitat e këtij ligji? Në rast se ka hasur vështirësi, cilat kanë qenë ato? A mendoni që dispozitat e këtij ligji janë të plota dhe a ka nevojë për ndryshime/plotësime të këtij ligji? Nga ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në vitin 2020, a janë nxjerrë në kohë të gjitha aktet nënligjore që parashikojnë nene në zbatim të këtij ligji? A është shtrirë zbatimi i këtij ligji dhe për rastet e palidhura me një procedim penal në rastin kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicie për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283, 283/a, 284/a të Kodit Penal? A është shtrirë zbatimi i këtij ligji për rastet e palidhura me procedimin penal në çështjet kur ka pasur indicie për		3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ligji (Anti-mafia) i ndryshuar”, regjistruar në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me numër rendor 66, datë 30.12.2025, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: Sa i përket pyetjes së 5-të, ku kërkohen të dhëna statistikore, konkretisht “Sa ka qenë numri i procedimeve penale për veprat penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” neni 259 dhe 260 të Kodit Penal? Po numri i dënimeve sa ka qenë?”, më poshtë gjeni të pasqyruara të dhënat mbi numrin e vendimeve përfundimtare (themel) të dhëna nga kjo gjykatë për këto vepra penale, si dhe numrin e të dënuarve, të ndara sipas viteve.		
--	--	--	--	--	--	--

		përfitim të paligjshëm pasuror për veprat penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” neni 259 dhe 260 i Kodit Penal? Sa ka qenë numri i procedimeve penale për veprat penale të “Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” neni 259 dhe 260 të Kodit Penal? Po numri i dënimeve sa ka qenë? Çfarë ndikimi ka pasur ndryshimi i vitit 2017 tani që procedura për masat parandaluese rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale, në vend të Kodit të Procedurës Civile? A respektohen afatet kohore të nenit 23 për kohëzgjatjen e gjykimeve (3 muaj)? Sa është kohëzgjatja mesatare?		• Për vitin 2025: - Janë dhënë 10 vendime për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dënuar 9 persona për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, njëri prej të cilëve është dënuar 2 herë (2 vendime të ndryshme). - Nuk është dhënë asnjë vendim për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. • Për vitin 2024: - Janë dhënë 8 vendime për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dënuar 8 persona për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni		
--	--	--	--	---	--	--

		A kanë qenë efektive ndryshimet e miratuara? Çfarë ka funksionuar, çfarë nuk ka funksionuar dhe pse? A kanë qenë të nevojshme këto ndryshime në ligj?		259 i Kodit Penal. - Nuk është dhënë asnjë vendim për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. • Për vitin 2023: - Janë dhënë 13 vendime për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dënuar 39 persona për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dhënë 3 vendime për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. - Janë dënuar 2 persona për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, njëri prej të cilëve është dënuar 2 herë (2 vendime të ndryshme).		
--	--	--	--	---	--	--

				• Për vitin 2022: - Janë dhënë 4 vendime për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dënuar 3 persona për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Nuk është dhënë asnjë vendim për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. • Për vitin 2021: - Janë dhënë 19 vendime për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Janë dënuar 28 persona për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.		
--	--	--	--	--	--	--

				- Nuk është dhënë asnjë vendim për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. • Për vitin 2020: - Është dhënë 1 vendim për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Është dënuar 1 person për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. - Nuk është dhënë asnjë vendim për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vëndorë</i>”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Për shkak të afatit kohor shumë të shkurtër, festave zyrtare të fundvitit, si dhe ngarkesës së trupës gjyqësore në këtë periudhë, gjykata aktualisht është në pamundësi objektive për t’ju dhënë informacion të plotë dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				shterues mbi pyetjet e parashtruar në kërkesën për informacion, të përcjellë nga ana juaj. Pyetjet e parashtruara nga ***** në këtë kërkesë për informacion i janë përcjellë trupës gjyqësore të GJKKO-së dhe sapo të kemi një përgjigje nga ana e saj do ju dërgohet informacioni i plotë, gjatë javës së ardhshme.		
1.	07.01.2026	Kërkesë për informacion: Sa persona janë dënuar nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga viti 2020 deri më tani për akuzën “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, kryer në kuadër të një grupi kriminal apo organizatës kriminale?	16.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 1, datë 07.01.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1. Për vitin 2025, ➤ Janë deklaruar fajtorë 7 (shtatë) persona për veprën penale “<i>Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale. ➤ Janë deklaruar fajtorë 5 (pesë) persona për veprën penale	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				<i>“Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i>, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, <u>jo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale.</u> 2. Për vitin 2024, ➤ Nuk është deklaruar fajtor asnjë person për veprën penale <i>“Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i>, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. 3. Për vitin 2023, ➤ Janë deklaruar fajtorë 4 (katër) persona për veprën penale <i>“Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”</i>, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale. ➤ Janë deklaruar fajtorë 6 (gjashtë) persona fizik, 2 (dy) prej të cilëve janë deklaruar fajtorë 2 (dy) herë (2 vendime të ndryshme) dhe 2 (dy) persona juridik për veprën penale <i>“Pastrim i produkteve të veprës</i>	
--	--	--	--	--	--

				<i>penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, <u>jo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale</u>. 4. Për vitin 2022, ➤ Nuk është deklaruar fajtor asnjë person për veprën penale “<i>Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. 5. Për vitin 2021, ➤ Janë deklaruar fajtorë 9 (nëntë) persona për veprën penale “<i>Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale. ➤ Janë deklaruar fajtorë 2 (dy) persona për veprën penale “<i>Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, <u>jo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo</u>		
--	--	--	--	--	--	--

				<u>organizatës kriminale.</u> 6. Për vitin 2020, ➤ Janë deklaruar fajtorë 2 (dy) persona për veprën penale “<i>Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale.		
2.	12.01.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së vendimit: Vendimi për mbylljen e dosjes mbi masakrën e Pëshkëpisë, vendim i marrë nga GJKKO në vitin 2019.	21.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj me objekt “Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit për mbylljen e dosjes mbi masakrën e Pëshkëpisë, vendim i marrë nga GJKKO në vitin 2019”, depozituar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me datë 12.01.2026 dhe regjistruar po në të njëjtën datë, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate, me numër rendor 2, ju informojmë si më poshtë: Vendimi që ju referoni në kërkesën tuaj është vendimi nr. 79, datë 06.12.2021, sipas të cilit është vendosur pushimi i çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 126, i	Përfunduar (Shkresa nr. 245 prot., datë 21.01.2026)	Nuk ka

				viti 2019, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për veprat penale “Veprat terroriste”, parashikuar nga neni 50/1 i Kodit Penal (ligji nr. 5591, dt. 15.06.1977, ndryshuar me ligjin nr. 6300, dt. 27.03.1981) dhe “Banda e armatosur”, e parashikuar nga neni 234/b i K.Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Çështja penale e mësipërme, për të cilën, nga kjo gjykatë është dhënë vendimi nr. 79, datë 06.12.2021, është shqyrtuar në seancë gjyqësore paraprake me dyer të mbyllura, në zbatim të nenit 329/b, pika 2 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.”</i>. Në këto kushte, në referim të ligjit nr. 119/2014 për të “Drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe nenit 103 të K.Pr.Penale, me titull “Ndalimi i publikimit të aktit”, i cili në pikën 3		
--	--	--	--	--	--	--

				të tij, parashikon shprehimisht se: “Ndalohe publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.” , gjykata refuzon kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 79, datë 06.12.2021. Përveç sa më sipër, në nenin 105 të K.Pr.Penale, me titull “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve”, në pikën 1 dhe 2 të tij, parashikohet shprehimisht se: “1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta, apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.”. Në interpretim të kësaj dispozite		
--	--	--	--	---	--	--

				ligjore, vlerësojmë se me togëfjalëshin “cilido që ka interes”, nënkuptohet prokurori, i dyshuari, personi nën hetim, i pandehuri, kallëzuesi, viktima ose trashëgimtarët e tij, palët private pra paditësi ose i padituri në padinë civile në procesin penal. Për sa më sipër, çmojmë se ju nuk përfshihen në rrethin e subjekteve procedurale që legjitimohen për të marrë kopje të vendimit nr. 79, datë 06.12.2021, të kësaj gjykate.		
3.	13.01.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së vendimit dhe akteve: Datë 13.01.2026 Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të më vihen në dispozicion të gjitha vendimet e çështjes: Prokuroria e Posaçme kundër znj. A.F (V).	21.01.2026	Ju informojmë se kërkesa juaj, e dërguar nëpërmjet emaili-t me datë 13.01.2026, me objekt “Kërkesë për vënie në dispozicion të të gjitha vendimeve të çështjes: Prokuroria e Posaçme kundër znj. A.F (V)”, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, është regjistruar po me datë 13.01.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me numër rendor 3. Po ashtu, kërkesa e depozituar në gjykatë nga ana juaj me datë 21.01.2026 ku, sipas ligjit nr.	Përfunduar (Shkresa nr. 11/2 prot., datë 22.01.2026)	Nuk ka

		Datë 21.01.2026 Sipas ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ju paraqes këtë kërkesë për t’u pajisur me vendimin nr. 28, datë 11.02.2021 i kësaj gjykate (vendim i marrë nga gjykata paraprake) si dhe të pajisem dhe të më vihet në dispozicion edhe kërkesa e prokurorit të posaçëm për pushimin e procedimit të çështjes penale nr. 160, viti 2020, regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186-1 i Kodit Penal, vendim ky i marrë në bazë të nenit 328/1/a të K.P.P. Kërkesa gjen mbështetje në dispozitën e mësipërme si dhe në të drejtën për informim, e drejtë kjo e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.		119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkon vënien në dispozicion të vendimit nr. 28, datë 11.02.2021 të kësaj gjykate dhe kërkesën e prokurorit të posaçëm për pushimin e procedimit të çështjes penale nr. 160, viti 2020, regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, është protokolluar në gjykatë me nr. 226 protokolli, datë 21.01.2026. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, të cilat referojnë për të njëjtin vendim të dhënë nga kjo gjykatë, konkretisht vendimin nr. 28, datë 11.02.2021, sipas të cilit, është vendosur pushimi i procedimit/çështjes penale me nr. 160, të vitit 2020, regjistruar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, ju bëjmë me dije si më poshtë. Çështja penale, që i përket procedimit penal nr. 160, të vitit 2020, për të cilën, nga kjo gjykatë është dhënë vendimi nr. 28, datë 11.02.2021, është		
--	--	---	--	---	--	--

				shqyrtuar në seancë paraprake me dyer të mbyllura, në zbatim të nenit 329/b, pika 2 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.”.</i> Në këto kushte, në referim të ligjit nr. 119/2014 për të “Drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe nenit 103 të K.Pr.Penale, me titull “Ndalimi i publikimit të aktit”, i cili në pikën 3 të tij, parashikon shprehimisht se: <i>“Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”</i>, gjykata refuzon kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr. 28, datë 11.02.2021 dhe		
--	--	--	--	---	--	--

				kërkesën e prokurorit të posaçëm për pushimin e procedimit të çështjes penale nr. 160, viti 2020. Përveç sa më sipër, në nenin 105 të K.Pr.Penale, me titull “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve”, në pikën 1 dhe 2 të tij, parashikohet shprehimisht se: “1. <i>Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta, apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.”.</i> Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, vlerësojmë se me togëfjalëshin “cilido që ka interes”, nënkuptohet prokurori, i dyshuari, personi nën hetim, i pandehuri, kallëzuesi, viktimi ose trashëgimtarët e tij, palët private pra paditësi ose i padituri në padinë civile në procesin penal. Për sa më sipër, çmojmë se ju nuk përfshihen në rrethin e subjekteve		
--	--	--	--	--	--	--

				procedurale që legjitimohen për të marrë kopje të vendimit nr. 28, datë 11.02.2021, të kësaj gjykate apo kërkesës së prokurorit të posaçëm për pushimin e procedimit të çështjes penale nr. 160, viti 2020.		
4.	14.01.2026	Kërkesë për informacion: Unë A.A, shtetas brazilian, mbajtës i pasaportës braziliane, aktualisht me banim në Tiranë-Shqipëri, paraqes këtë deklaratë në lidhje me procedurat në të cilat jam palë e hetuar/e akuzuar, në lidhje me krimin e moskallëzimit të një krimi. Sipas informacionit të marrë, faza e hetimit ka përfunduar dhe çështja është aktualisht nën shqyrtim nga kjo gjykatë. Kërkoj: Informacion mbi statusin aktual të procedurave; Nëse Zyra e Prokurorit Publik ka lëshuar tashmë një deklaratë; Nëse ka një seancë dëgjimore të planifikuar apo vendim fillestar. Çështja ka të bëjë me mosraportimin e prostitucionit. Datë 19.01.2026	19.01.2026	Datë 19.01.2026 Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 4, datë 14.01.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Nga verifikimet e kryera në Kryesekretarinë e kësaj gjykate si dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, nuk rezulton që ju të jeni palë si “i pandehur” në ndonjë nga çështjet penale që po shqyrtohen aktualisht në seancë gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Datë 20.01.2026	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Nuk është krim i organizuar, më akuzuan se nuk kam raportuar një rast prostitucioni.		Ju bëjmë me dije se adresat elektronike me të cilat ju keni komunikuar i përkasin Sekretarisë dhe Specialistit të Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo gjykatë së cilës ju i jeni drejtuar disponon informacion vetëm mbi çështjet penale që shqyrtohen pranë kësaj gjykate dhe jo për çështjet që shqyrtohen pranë gjykatave të tjera në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, ju informojmë se, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk kanë në kompetencën e tyre gjykimin e veprave penale që lidhen me prostitucionin, me përjashtim të rastit kur këto vepra penale kryhen në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, organizatës kriminale, organizatës terroriste dhe bandës së armatosur. Sipas asaj që ju referoni në kërkesën tuaj, ju jeni akuzuar për veprat penale		
--	--	---	--	---	--	--

				që lidhen me prokurorin, por jo në kuadër të krimit të organizuar, në këto kushte ju sugjerojmë t'i drejtoheni gjykatave të tjera që mund të kenë në shqyrtim çështjen tuaj. Siç ju është bërë me dije edhe në email-in e datës 19.01.2026, ju rrithekojmë se nga verifikimet e kryera në Kryesekretarinë e kësaj gjykate si dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, nuk rezulton që ju të jeni palë si “i pandehur” në ndonjë nga çështjet penale që po shqyrtohen aktualisht në seancë gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për t'ju ardhur në ndihmë po ju dërgoj edhe link-un ku mund të gjeni faqet zyrtare të të gjitha Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, të cilat në rubrikën “Na kontaktoni” kanë të publikuara adresat zyrtare elektronike të kontaktit për secilën gjykatë. https://gjykata.gov.al/		
--	--	--	--	--	--	--

5.	27.01.2026	Kërkesë për informacion: Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj informacion nga gjykata e posaçme për dispozitivin e vendimit të shpallur nga GJKKO në 23 Janar për të pandehurit: M.S, F.M, N.S dhe M.H.	28.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 5, datë 27.01.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur këtij email-i po ju dërgojmë njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate, në rubrikën “Njoftime për mediat”.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
6.	28.01.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së vendimit: Bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën për Informim", kërkoj informacion nga Gjykata e Posaçme (GJKKO) si më poshtë vijon: 1. Vendimin numër 65, datë 17 tetor 2025 me të pandehur B.R, L.R, A.M dhe R.D.	02.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 6, datë 28.01.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë se: Vendimi nr. 65, datë 17.10.2025, me të pandehur B.R, etj... është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rubrikën “Çështjet gjyqësore”, nënrubrika “Çështjet	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				penale”. Linku përkatës: https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/		
7.	02.02.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së vendimeve: Në kuadër të projektit antikorrupsion “*****”, i zbatuar nga një kompani konsulente nga Republika e ***** dhe për qëllime studimore më nevojiten vendimet për masat e sigurimit personal të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për subjektet e mëposhtëm: E.V, Kryetar i Bashkisë Tiranë; I.B, ish Ministër i Shëndetësisë	10.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 7, datë 02.02.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, i ndryshuar, ju informojmë se: Së pari, ndaj shtetasve P.N dhe S.Q nuk është caktuar asnjë masë sigurimi personal nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Së dyti, vendimet për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve E.V, I.B, J.M, E.B, G.Gj,	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		dhe Drejtor i SASPAC; S.Q, ish-Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH; J.M, ish kreu i Komisionit të Prokurimeve Publike; P.N, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme; E.B, ish-Drejtor i ARRSH; G.Gj, ish-Drejtor i ARRSH; E.E, Drejtor i KESH; M.K, Drejtor i AKSHI, B.B, zv.Kryeministër		E.E, M.K dhe B.B janë vendime të dhëna në dhomë këshillimi gjatë fazës së hetimeve paraprake, në zbatim të nenit 244, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon shprehimisht se: “<i>Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar.</i>”. Bazuar në nenin 103, pika 1, 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon shprehimisht se: “1. <i>Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.</i>”,		
--	--	---	--	--	--	--

				gjkata refuzon kërkesën tuaj për t'ju vënë në dispozicion vendimet për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve të sipërcituar, si vendime të dhëna në dhomë këshillimi gjatë fazës së hetimeve paraprake. Përveç sa më sipër, ju bëjmë me dije se në nenin 17, pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “<i>E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale</i>”.		
8.	02.02.2026	Kërkesë për informacion: Po punojmë mbi një shkrim lidhur me çështjen penale ku Gjyqtarja F.H ka kompetencë, për veprat penale të shqyrtuara: “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” kundër dy ose më shumë personave, e kryer në bashkëpunim dhe në formën e grupit të strukturuar kriminal	05.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 8, datë 02.02.2026 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë:	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		(nenet 79/dh dhe 28/4 të Kodit Penal). “Falsifikimi i dokumentave” (neni 333/a i Kodit Penal). Ku të pandehur janë E.H.Sh, I.A.R, I.K.T, L.S.R, L.A.B, L.Nj.D, V.Y.B. Kërkojmë nga ana juaj informacion: 1. Kur kanë filluar seancat për këtë çështje? 2. Sa seanca janë mbajtur deri më tani? 3. Çfarë masash po merr gjykata për përshpejtimin e procesit gjyqësor?		1. Seanca e parë e themelit për dosjen penale në ngarkim të të pandehurve E.Sh, etj... është zhvilluar me datë 28.09.2022. 2. Deri më tani për këtë dosje penale janë zhvilluar 99 (nëntëdhjetë e nëntë) seanca gjyqësore. 3. Në kushtet që, shkak për shtyrjen e seancave në mënyrë të vazhdueshme ka qenë mosparaqitja e mbrojtësve, gjykata ka marrë të gjitha masat e nevojshme për vijimin normal të gjykimit, të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, konkretisht në: Nenin 49, pika 5 dhe 6 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“5. Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori zbaton paragrafin 4, të nenit 350, të këtij Kodi. Nëse mungesa e tij është e përligjur, gjykata ose prokurori mund të caktojë si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit. 6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për</i>	
--	--	---	--	--	--

				<i>shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.”.</i> Nenin 265, pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:... b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.”.</i> Nenin 350, pika 4 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“4. Kur mbrojtësi i njoftuar rregullisht nuk paraqitet në seancë dhe nuk ka pengesa që e përjashtojnë nga përgjegjësia për t’u paraqitur ose nëse mbrojtësi ikën nga seanca pa leje, gjykata mund të caktojë ndaj tij gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe mund ta urdhërojë të paguajë shpenzimet e seancës.”.</i> Gjykimi i kësaj çështje penale vijon me rregullat e gjykimit të zakonshëm, marrjen dhe verifikimin e provave në seancë gjyqësore dhe aktualisht		
--	--	--	--	---	--	--

				ndodhet në fazën e marrjes së provave që gjykata ka pranuar me kërkesë të mbrojtësve dhe personalisht të të pandehurve.		
9.	06.02.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së vendimit: Kërkoj zyrtarisht një kopje të vendimit të zbardhur për çështjen penale të vitit 2004, ku përfshihet shtetasi: A.K 02/06/1969, *****. Sipas konfirmimit zyrtar që kam marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ky shtetas ka vuajtur dënimin në IEVP Shënkoll (Lezhë) në bazë të një vendimi të Gjykatës për Krime të Rënda të vitit 2004. Besoj se ky vendim është pjesë e dosjes së bashkëlidhur me shtetasin Z.K dhe të tjerë, e regjistruar në vitin 2004. Kërkoj të më vihet në dispozicion ky vendim për të verifikuar kualifikimin ligjor të veprës penale dhe detajet e dënimit.	10.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 9, datë 06.02.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: Nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të çështjeve të kësaj gjykate, si dhe në zyrën e Arkivës të po kësaj gjykate, për periudhën kohore 2004 – 2007 nuk rezulton që të jetë dhënë ndonjë vendim dënimi ndaj shtetasve A.K apo Z.K nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Nëse mund të na orientoni me numër dhe datë konkrete vendimi, veprën penale për të cilën është dënuar, apo ndonjë emër tjetër të pandehuri që ka qenë pjesë e të njëjtës dosje penale, në mënyrë që të verifikojmë nëse kjo dosje penale që ju citoni në kërkesën	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				tuaj është gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë apo jo.		
10.	18.02.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit: Në funksion të detyrës dhe bazuar në ligjin Nr.119/2014 "Për të Drejtën për Informim", kërkoj informacion nga Gjykata e Posaçme (GJKKO) si më poshtë vijon: 1. Vendimin numër 68, datë 3 nëntor 2025 me të pandehur J.Ç, A.M dhe A.H.	19.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 10, datë 18.02.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju informojmë se: Vendimi nr. 68, datë 03.11.2025, me të pandehur J.Ç, etj... është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rubrikën “Çështjet gjyqësore”, nënrubrika “Çështjet penale”. Linku përkatës: https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				penale/		
11.	24.02.2026	Kërkesë për informacion: ****, në kuadër të projektit “****” po monitoron transparencën dhe standartet procedurale të proceseve të emërimit/zgjedhjes së zyrtarëve të lartë. Në këtë kuadër bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkojmë vënien në dispozicion të informacionit të mëposhtëm, lidhur me funksionimin administrativ dhe organizativ të gjykatës suaj: -Organika e miratuar e gjykatës dhe numri i gjyqtarëve të parashikuar; -Numri aktual i gjyqtarëve në detyrë; -Numri i vendeve vakante dhe data e krijimit të secilës vakancë; -Shkaqet e vakancave (p.sh. përfundim mandate, dorëheqje, shkarkim, rivlerësim kalimtar, masa administrative). Nëse, gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim, janë	05.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me numër rendor 11, datë 24.02.2026, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë si më poshtë: 1) Bashkëlidhur këtij email-i gjeni strukturën organizative dhe organigramën e GJKKO-së. Numri i gjyqtarëve të parashikuar në strukturën organizative të kësaj gjykate është 16 (gjashtëmbëdhjetë). 2) Aktualisht pranë kësaj gjykate ushtrojnë funksionin 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë, 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë janë të emëruar dhe 4 (katër) gjyqtarë janë të caktuar në detyrë me skemë delegimi. 3) Siç është përshkruar dhe më sipër, pranë kësaj gjykate aktualisht është vetëm 1 (një vend) vakant për	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		marrë masa administrative (pezullim nga detyra, largim nga sistemi, përfundim mandati ose mosvazhdim ushtrim funksioni) ndaj gjyqtarëve, si pasojë e: -proceseve të rivlerësimit kalimtar; -zbatimit të ligjit nr. 138/2015; Për secilin rast (nëse ka), kërkojmë informacion vetëm mbi: -funksionin; -llojin e masës administrative; -datën e vendimit; -organin kompetent vendimmarrës.		gjyqtarë. 4) Sa i përket shkaqeve të vakancave, ju bëjmë me dije se që prej fillimit të funksionimit të GJKKO-së me datë 19.12.2019, trupa gjyqësore e kësaj gjykate nuk ka qenë asnjëherë e plotësuar sipas numrit të parashikuar në strukturën e saj organizative. Plotësimi i trupës gjyqësore është realizuar gradualisht gjatë viteve. Sa ju përket shkaqeve të largimit të disa prej gjyqtarëve, të cilët kanë ushtruar funksionin pranë GJKKO-së në periudha të ndryshme, ju bëjmë me dije se: 1 (një) gjyqtar është emëruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 1 (një) gjyqtar është emëruar në Gjykatën e Lartë, 3 (tre) gjyqtarë janë emëruar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, 1 (një) gjyqtar është emëruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 1 (një) gjyqtar është larguar me dorëheqje. 5) Gjatë periudhës 01.09.2025 dhe në vijim, nuk është marrë asnjë masë administrative ndaj gjyqtarëve të GJKKO-së, si pasojë e procesit të	
--	--	---	--	---	--

				rivlerësimit kalimtar apo zbatimit të ligjit nr. 138/2015.		
--	--	--	--	---	--	--